



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 10 korrik 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1167_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 16 paragrafi 5 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për Lëshimin e Autorizimit V_737_2015 të datës 15 qershor 2015 për shoqërinë "EKO ENERGJI" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Morava e Binçës HC Binça, me kapacitet të instaluar prej 0.6 MW, në lokacionin ZK Binça, komuna e Vitisë;
- Vendimin për Modifikimin e Autorizimit V_892_2017 të datës 27 shkurt 2017 për shoqërinë "EKO ENERGJI" SH.P.K., të Autorizimit Final V_737_2015 të datës 15 qershor 2015 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Morava e Binçës HC Binça, nga kapaciteti i instaluar prej 0.6 MW në kapacitetin instalues 1 MW, në lokacionin ZK Binça, komuna e Vitisë;
- Vendimin V_929_2018 të datës 29 mars 2018 për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit V_737_2015 të datës 15 qershor 2015 i Modifikuar me Vendimin V_892_2017, lëshuar shoqërisë "EKO ENERGJI" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Morava e Binçës HC Binça, me kapacitet të instaluar prej 1 MW, në lokacionin ZK Binça, komuna e Vitisë;
- Vendimin V_979_2018 të datës 13 qershor 2018 për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit V_737_2015 të datës 15 qershor 2015 i Modifikuar me Vendimin V_892_2017, lëshuar shoqërisë "EKO ENERGJI" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Morava e Binçës HC Binça, me kapacitet të instaluar prej 1 MW, në lokacionin ZK Binça, komuna e Vitisë;
- Kërkesën për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë të Autorizimit V_737_2015 të datës 15 qershor 2015 edhe për 6 (gjashtë) muaj, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Morava e Binçës HC Binça, me kapacitet të instaluar prej 1 MW, në lokacionin ZK Binça, komuna e Vitisë, të datës 07.05.2018 të shoqërisë "EKO ENERGJI" SH.P.K., me adresë fshati Pozharan pn Viti, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 10 korrik 2019 nxori këtë:

V E N D I M



- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë “EKO ENERGI” SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit V_737_2015 të datës 15 qershor 2015, Modifikuar me Vendimin V_892_2017 dhe i vazhduar me vendimin V_929_2018 të datës 29 mars 2018 dhe V_979_2018 të datës 13 qershor 2018 për ndërtimin e Hidrocentralit HC Binça me kapacitet instalues prej 1 MW, në Lumin Morava e Binçës, në lokacionin ZK Binça, komuna e Vitisë, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me **15 dhjetor 2019 për përfundimin e ndërtimit të Hidrocentralit.**
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizimit V_737_2015 të datës 15 qershor 2015, i vazhduar me Vendimin V_929_2018 të datës 29 mars 2018 dhe Vendimin V_979_2018 i datës 13 qershor 2018 do të vlen deri me datë **15 dhjetor 2019**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi.
- III. Shoqëria “EKO ENERGI” SH.P.K., obligohet të përfundoj ndërtimin e hidrocentralit HC Binça deri me 15 dhjetor 2019 dhe në rast se nuk arrin ta përfundoj ndërtimin brenda këtij afati, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, Vendimi për Lëshimin e Autorizimit V_737_2015 i datës 15 qershor 2015 do të shfuqizohet.

Arsyetim

- o ZRRE me datë 13.08.2014 nga shoqëria “EKO ENERGI” SH.P.K., ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Morava e Binçës HC Binça, me kapacitet instalues prej 0.6 MW, në lokacionin ZK Binça, komuna e Vitisë.
- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria “EKO ENERGI” SH.P.K., ka vendosur se ky aplikacion ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_671_2014 me datë 23 dhjetor 2014, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit Final për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- o ZRRE me datë 20.05.2015 nga shoqëria “EKO ENERGI” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizimin Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Morava e Binçës HC Binça, me kapacitet instalues prej 0.6 MW, në lokacionin ZK Binça, komuna e Vitisë, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 15 qershor 2015 pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit, ka vendosur që shoqërisë “EKO ENERGI” SH.P.K., ti lëshohet Autorizimi Final V_737_2015 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Morava e Binçës HC Binça, me kapacitet instalues prej 0.6 MW, në lokacionin ZK Binça, komuna e Vitisë.



- ZRRE me datë 25.01.2017 nga shoqëria “EKO ENERGI” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për Modifikimin e Autorizimit Final V_737_2015, për ndryshimin e kapacitetit gjenerues të Hidrocentralit në Lumin Morava e Binçës, HC Binça nga kapaciteti instalues prej 0.6 MW në kapacitetin instalues prej 1 MW, ZK Binça, duke i plotësuar kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me të drejtën e shfrytëzimit të ujit të lëshuar nga MMPH dhe Lejen Ndërtimore të lëshuar nga komuna e Vitisë.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në mbledhjen e mbajtur me datë 27 shkurt 2017 ka aprovuar kërkesën për Modifikimin e Autorizimit Final V_737_2015, duke lejuar ndryshimin e kapacitetit gjenerues nga kapaciteti instalues prej 0.6 MW në kapacitetin instalues prej 1 MW, me vendimin V_892_2017 bazuar në ndryshimin e Lejes Ujore dhe të Lejes së Ndërtimit të lëshuar nga organet kompetente dhe legjislacionin në fuqi.
- ZRRE me datë 03.07.2017 nga shoqëria “EKO ENERGI” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_737_2015 të datës 15 qershor 2015, i modifikuar me vendimin V_892_2017 të datës 27 shkurt 2017 për HC Binça kapaciteti instalues prej 1 MW, ZK Binça, komuna e Vitisë, **për kompletimin e ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 15 qershor 2018.**
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 mars 2018, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmive relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë “EKO ENERGI” SH.P.K., dhe me vendimin V_929_2018 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_737_2015 të datës 15 qershor 2015 edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 15 qershor 2018, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e Autorizimit.
- ZRRE me datë 07.05.2018 shoqëria “EKO ENERGI” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_737_2015 të datës 15 qershor 2015 i vazhduar me Vendimin V_929_2018 të datës 29 mars 2018, për HC Binça me kapacitet të instaluar prej 1 MW, edhe për një afat shtesë **për zgjatjen e periudhës së ndërtimit edhe për 12 (dymbëdhjetë) muaj, gjegjësisht deri me 15 qershor 2019.**
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 13 qershor 2018, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmive relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë “EKO ENERGI” SH.P.K., dhe me vendimin V_979_2018 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_737_2015 të datës 15 qershor 2015 edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 15 qershor 2019, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e Autorizimit.
- ZRRE me datë 11.06.2019 shoqëria “EKO ENERGI” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_737_2015 të datës 15 qershor 2015 i vazhduar me Vendimin V_929_2018 të datës 29 mars 2018 dhe Vendimin V_979_2018 të datës 13 qershor 2018 për HC Binça me kapacitet të instaluar prej 1 MW, edhe për një afat shtesë **për zgjatjen e periudhës së ndërtimit edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me 15 dhjetor 2019.**
- Shoqëria EKO ENERGI SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: kompania “EKO ENERGI” SH.P.K., ka përfunduar më shumë se 98% të punimeve të ndërtimit të Hidrocentralit HC Binça



me kapacitet të instaluar prej 1 MW, mirëpo për shkak të kushteve dhe reshjeve hidrometrologjike nuk ka mundur ti përfundoj të gjitha punët në afatin e parashikuar.


- Shoqëria "EKO ENERGI" SH.P.K., ka shqyrtuar se ka përfunduar veprën e marrjes-kaptazhën, montimin e turbinave dhe gjeneratorëve, montimin e tubacionit në gjatësi prej 2130 metrave, ndërsa brenda pak kohe planifikon të përfundoj tubacionin edhe për 150 metra të mbetura. Gjithashtu ka sqaruar se është në përfundim e sipër të lartë përçuesi i rrjetit energjetik.
- Andaj, kanë kërkuar që tu lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Vendimit V_737_2015 i datës 15 qershor 2015, edhe për një afat prej 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me **15 dhjetor 2019 për përfundimin e ndërtimit të Hidrocentralit.**
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës të shoqërisë EKO ENERGI" SH.P.K., për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Morava e Binçës HC Binça, me kapacitet instalues prej 1 MW, në lokacionin ZK Binça, komuna e Vitisë, ka vlerësuar ato, dhe duke u mbështetur edhe në shkresat e lëndës, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_737_2015 i datës 15 qershor 2015, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.

IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janovë, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Vitisë,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.